

Ligjërimi i shkurtër është i përshtatshëm për hyrje në ndonjë temë të re si dhe për ndërmjetësimin e njohurive të reja. Gjithashtu përshtatet për zgjerimin e njohurive të mësuara, si dhe për përmbledhjen dhe përcjelljen e tyre tek nxënësit. Në përgatitje për ligjërime të tilla, çdo mësues do të duhej të zhvillonte, me nxënësit, konsultime të hollësishme.

Gjatë një ligjërimi të shkurtër do të duhej ti keni parasysh pikat në vijim



1. Ju bëni renditjen dhe ndërlidhjen e temës duke ndërlidhur njohuritë paraprake të nxënësit.
2. Përmbajtjet thelbësore (Pikat kyçe të temës, problemet) i prezentoni hap pas hapi.
3. Ju i tregoni mundësitë e aplikimit në punë praktike.
4. Në ndërlidhje të mëtejme potenconi problemet kryesore dhe pikënisjet e zgjedhjeve.
5. Mos harroni, të falenderoheni për vëmendje dhe të pyesni mos ka ndonjë pyetje.

Gjatë përgatitjes për provimin praktik më është dashur të konstatoj se disa nxënësve në grupin tim u munguan bazat teorike.

Pasi që unë kisha shumë pak kohë për ndërmjetësim të njohurive të mangëta, vendosa të bëjë një ligjërime të shkurtër.

Kushtet e përgjithshme

- Dhoma e ndriçuar
- Akustikë e mirë e dhomës
- Mediat: fletoret, flipchart, modelet, overheadprojektori, dërrasëz afishimi (Pinnwand)

Përparësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Ndërmjetësimi i një materiali të gjërë për një kohë të shkurtë - Numër i dëshirueshëm i atyre që u drejtoheni - Mësuesi mban iniciativën - Kohë përgatitore relativisht e shkurtë 	<ul style="list-style-type: none"> - Roli pasiv i dëgjuesit - Devijim mendor i nxënësve - Kuotë e vogël e të mbajturit mend - Nuk mund të mirret parasysh niveli i ndryshëm i njohurive - Vazhdim i shpejtë i informatave

Mangësitë e një ligjërime të shkurtë mbisundojnë përparësitë e tij. Për këtë shkak, keni parasysh se vetëm për kohë të caktuar ligjërata e shkurtë ka arsyeshmërinë e saj. Një ligjërime i shkurtë gjatë tërë një njësie mësimore është i papranueshëm, por në kombinim me metodat që kanë pikëqëndrim nxënësin, ka arsyeshmërinë e saj.